

E nderuar Znj. Gjoka!

Ju bëjmë me dije se kërkesa juaj për informim, në cilësinë (medias) BIRN Albania, ku kërkonte informacion për problematikat dhe komunikimin e Autoritetit të Dosjeve me Kuvendin e Shqipërisë në lidhje me zëvendësimin e anëtarit të këtij institucioni Daut Gumeni, është regjistruar me datë 08.10.2021.

Ju bëjmë me dije se nga ana e Autoritetit është reaguar pranë institucioneve përgjegjëse në vite mbi boshllëkun e krijuar dhe pengesat e vështirësitë e ndeshura në ushtrim të funksionit.

Nga mungesa e anëtarit të pestë në disa raste vendimet janë marrë me numër të barabartë votash (dy me dy) ku në zbatim të rregullores këto raste kanë kaluar në rivotim, bazuar në Ligjin për Organet Kolegjiale nr. 8480, datë 27.05.1999, Rregulloren për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit për Informim, miratuar me Vendimin e Autoritetit për Informim nr. 21, datë 09.05.2017 dhe ndryshuar me Vendimin e Autoritetit Nr. 234, datë 24.04.2019. Këto akte normative normojnë veprimtarinë e institucionit tonë.

Vetëm për vitin 2020-2021 janë 19 raste të kaluara me procedurë rivotimi. Informacion mbi keto vendime dhe vendimet e tjera, janë të publikuara në faqen zyrtare internetit të institucionit [Autoriteti i Dosjeve \(autoritetidosjeve.gov.al\)](http://autoritetidosjeve.gov.al).

Bashkëlidhur po ju dergojmë reagimet tona zyrtare pranë Kuvendit të Shqipërisë dhe raportimet e përvitshme pranë tij, si organi i përzgjedhjes dhe emërtesës.

Duke ju falenderuar

**Kordinatori i të drejtës për informim pranë AIDSSH**

**Selami Zalli**

E-MAIL: selami.zalli@autoritetidosjeve.gov.al.